



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2 nën pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 40 paragrafi 2 nën pikën 5 të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës në seancën e IX-të të rregullt për vitin 2018, mbajtur, më dt.26.10.2018, mori këtë:

V E N D I M

Formimi i Komisionit për Ankesa për Emërtimin e Rrugëve, Shesheve dhe Vendbanimeve në territorin e Komunës së Klinës

I

Formohet Komisioni për Ankesa për Emërtimin e Rrugëve, Shesheve dhe Vendbanimeve, në territorin e Komunës së Klinës

II

Komisioni si në pikën 1 të këtij Vendimi ka 7 anëtarë, si në vijim:

1. Petrit Palushaj-AAK
2. Enver Gashi-LDK
3. Isa Ibishi-PDK
4. Xhevxhet Berisha-VV
5. Tush Deda-PSHDK(Grupi IQPK, AKR dhe PSHDK)
6. Njomza Grabanica-Ekzekutivi
7. Iber Elezaj - Ekzekutivi

III

Komisioni si në pikën 2 të këtij Vendimi është obligativ që të angazhohet në shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve posa të përfundojë procedura e sistemit të adresave sipas vendimit të fundit të Kuvendit të Komunës, Nr.01Nr.06-4427/2015, i miratuar më 20.07.2015.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës.

V

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, anëtarët e Komisionit, Zyra Ligjore, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-7295 2018
Klinë, më dt. 05.11 2018

Kryesuesi,
Fadil Gashi